

REPublika e Kosovës / Republika Kosovo  
Organi Shqyrtues i Prokurimit / TeLo za Razmatranje Nabavki

Nr/Br. 100/20  
Datë/Datum. 11.02.20  
PRISHTINË - PRIŠTINA

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Autoriteti Kontraktues Komuna e Junikut

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 636-19-5225-5-1-1

Sa i përket tenderit për Ndërtimi i rrugës Junik-Gjeravicë

## ANKESË

### 1. Identifikimi i ankuesit\*

"Joos & Krasniqi-Bazë" Sh.p.k  
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Junik

(Adresa)

Junik

(Vendi)

+383 48 999 014

+383 44 999 014

(Numri Telefonit)

Granit Krasniqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

granit.krasniqi@jooskrasniqi.com

(Adresa elektronike)

11.02.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

51050

(Kodi postar)

(Numri i Faks-it)



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Data e parë e njoftimit të kontratës në KRPP: 18.07.2019  
Afati i fundit për dorzim të tenderit: 26.08.2019  
Data dhe ora e fillimit të procesit të hapjes së tenderit: 26.08.2019 në ora 14:00  
Kriteri për dhënie të kontratës: Çmimi më i ulët  
Njoftim për refuzimin e tenderit me e-mail në E-prokurim dt:18.09.2019  
Data e Parashtrimit të Kërkesës për Rishqyrtim 20.09.2019  
Njoftim mbi vendimin e Ri-Vlersimit 03.10.2019  
Me dt:04.10.2019 Kemi paraqitur Ankes pranë OSHP-së  
Me dt:21.10.2019 Ka ardh vendimi i Ekspertit Shqyrtues  
Me dt:31.10.2019 Ka ardhur vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit Oshp-së  
Me dt:13.11.2019 Njoftim për refuzimin e tenderit me e-mail në E-prokurim  
Me dt:14.11.2019 Kemi parashtruar kërkesë për Rishqyrtim  
Me dt:21.11.2019 Njoftim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim  
Me dt:21.11.2019 Kemi paraqitur ankes pranë OSHP-së  
Me dt:06.12.2019 Kemi pranuar mendimin e ekspertit shqyrtues  
Me dt:26.12.2019 Ka ardhur vendimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit OSHP-së  
Me dt:29.01.2020 Vendimi i Autoriteti Kontraktues  
Me dt:03.02.2020 Kemi parashtruar kërkesë për Rishqyrtim  
Me dt:06.02.2020 kemi vrejtur se na është Refuzuar kërkes për Rishqyrtim permes E-Prokurimit

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☐

**5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet**

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëturjeshe në aktivitetin e prokurimit ?*

Po

☒

Jo

☐

**6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve**

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po

☒

Jo

☐

*Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.*

**7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1  
Neni 7  
Neni 24 pika 2  
Neni 51  
Neni 56  
Neni 59  
Neni 60  
Neni 68  
Neni 69  
Neni 72  
Neni 80



*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjohë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Gjatë procedurës së aktivitetit të prokurimit Autoriteti Kontraktues në këtë rast Komuna e Junikut, ka bërë shkelje të Ligjit për Prokurim Publik, përkatësisht neneve të lartëcekura. Duke devijuar nga kriteret e përzgjedhjes të vendosura në Dosjen e Tenderit. Me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit është shkelur rëndë Lpp-ja me nr.04/L-042, e plotësuar dhe ndryshuar me Lpp nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe 05/L-92. Duke shkelur Nenin 1,7,24, Neni 51,56 Neni 59, Neni 60,68,69,72, Neni 80

Ku konkretisht në Nenin 59 paragrafi 4 thuhet: Autoriteti Kontraktues do të konsideroj një Tender si të përgjegjshëm, vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmeri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e Tenderit. Pavarsisht nga e mëparshmja, Autoriteti Kontraktues mund të konsideroj një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabimet ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime material, ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në Njoftimin e Kontrates dhe në Dosjen Tenderit. Me kusht që çfarëdo devijimi i tillë të kualifikohet, aq sa është e mundshme dhe të merret parasysh gjatë vlersimit dhe krahasimit të tenderëve.

Me dt: 26.12.2019 kemi pranuar një vendim të cilin e ka marr Organi Shqyrtues i Prokurimit - OSHP-ja, me nr 831/19 vendim në të cilin thuhet: "*Paneli shqyrtues Obligon Autoritetin Kontraktues që gjatë rivlerësimit ti respektoj ne përpikëri të gjitha dispozitat e LPP-se dhe kërkesat e vendosura në njoftimin për kontrate dhe dosje të tenderit, Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së".*

Me dt: 06.01.2020 kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues që të na informojë se ku ka mbetur procedura e prokurimit në lidhje me tenderin "Ndërtimit i rrugës Junik – Gjeravicë" sepse që nga data 26.12.2019 nuk kemi pranuar asnjë njoftim rreth kësaj çështje. AK – Komuna e Junikut e ka kthyer lëndën në rivlerësim dhe ne si OE nuk jemi njoftuar rreth rivlerësimit deri me datën 08.01.2020 pasi ne kemi kërkuar nga AK që të informohemi për rrjedhën e procesit.

Me dt: 29.01.2020 ne kemi pranuar vendimin e AK – Komuna e Junikut, mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyen se të gjitha OE-të janë të papërgjegjshëm.



Kemi kërkuar çasje në dokumentet të këtij projekti më konkretisht në raportin e rivlerësimit. Me pranimin e këtij raporti ne kemi vërejtur se janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së dhe procedurave bazë të Prokurimit.

Ne si koncerzium "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k & PEVLAKU Sh.p.k jemi operatorë të përgjegjshëm, një gjë e konfirmuar edhe në vendimin e OSHP-së (nr 831/19). Nga këtu kemi vërejtur se Prokurimi në Komunën e Junikut nuk ka përfillur atë se çka është kërkuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit – OSHP-ja.

Komisioni i rivlerësimit me rivlerësimin e lëndës ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së, me rekomandimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugës Junik – Gjeravicë".

AK – Komuna e Junikut ka thënë që ne jemi eliminuar për arsye se: *"Sepse nuk e plotëson kërkesën me nr.3, të pikës III.2.3. Kapaciteti ekonomik dhe financiar të paraqitur në Njoftim për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit si dhe kërkesat me nr.9 dhe 10, të pikës III.2.4. Kapaciteti teknik dhe profesional siq është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit"*.

Tek raportit i rivlerësimit nga AK dhe komisioni rivlerësues, sipas tyre ne nuk jemi të përgjegjshëm në këto pika.

Pika I: *Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë në vlerë prej së paku 300, 000.00 €.*

SQARIMI I: Ne si koncerzium "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k & PEVLAKU Sh.p.k kemi paraqitur mbështetje bankare nga Raiffeisen BANK, me numër të referencës: MD1923400003 të datës 23 Gusht 2019. Ky dokument është i bashkangjitur në dosjen e tenderit e paraqitur nga ana jonë, gjithashtu do ta gjeni bashkangjitur si dëshmi edhe në këtë ankesë.

Pika II: *Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi nga Banka Listat e pagave që dëshmojnë se janë kryer obligimet ndaj stafit dhe punëtorëve.*

SQARIMI II: Ne si koncerzium "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k & PEVLAKU Sh.p.k kemi paraqitur dëshmi mbi pagesën e pagave të punëtorëve nga banka siq është kërkuar në FDT, si dhe dëshmi nga Administrata Tatimore e Kosovës dokumente të cilat janë të bashkangjitura në dosjen e tenderit. Nëse AK – Komuna e Junikut ka qenë në dilemë në këtë pikë ka mundur që të kërkojë informacione nga ATK-ja, gjithashtu do t'i gjeni bashkangjitur si dëshmi edhe në këtë ankesë.

Pika III: *1(një) Buldozer D7,7(shtatë) Ekskavator te ndryshem, 1(një) Ekskavator me çekan pneumatic, 2(dy) Kamion kiper min. Peshë 40 t, , 1(një) Kamion min. Peshë 20 t, 1(një) Kamion kiper i vogel min. Peshë 7 t, 1(një) Kamion me korpë, dy (2) Kokë tërheqëse, 18 t, dy (2). Gjysëmrimorkio min.30 t, 1 (një) Rimorkio e rëndë min.50 t, 3(tre) Kamionetë dubelkabinë, 3 (tre) Ngarkues, 3(tre) Cilindër vibrues (makine ngjeshëse), 1(një) Makinë ngjeshëse me cilindër me dhembëza, 2(dy) Grejder (makinë për nivelizimin e rrugëve), 1(një) Çekan hidraulik, dy (2) Auto pompë betoni, 3 (tre) Kamion per transport te betonit (Autobetonierkë – mixer), 1(një) Auto Cisternë, Pajisjet e nevojshme për punët e asfaltit dy (2) Cilindrat me rrota hekuri me vibrim, 1(një) Spërkatës për bitumen dhe emulsion, dy (2) Makina për gërryerjen e asfaltit, 1(një) Kamion special fshisë për pastrimin e rrugëve,*



*1(një) Prerëse e asfaltit, 1 (një) Komperesor, 7(shtatë) Kamion kiper për transport të asfaltit të gatshëm minimumi 32 t.*

**SQARIMI III:** Të gjitha këto makineri të cilat komisioni i vlerësimit ka thënë që ne si posedojmë sipas raportit të rivlerësimit i bëjmë me dije komisionit të rivlerësimit si dhe zyrën e prokurimit në Junik se ne si koncerzium "Joos&Krasniqi-Bazë" Sh.p.k & PEVLAKU Sh.p.k i posedojmë të gjitha këto makineri. Këto makineri gjithashtu do t'i gjeni bashkangjitur si dëshmi edhe në këtë ankesë.

Me datën 03.02.2020 kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK Komuna e Junikut. Me datën 06.02.2020 kemi vërejtur në E-Prokurim se është ngarkuar përgjigja mbi refuzimin e kërkesës tonë mirëpo, ne si OE nuk jemi njoftuar fare përmes e-prokurimit apo e-mail që kërkesa jonë është refuzuar.

Pas refuzimit të bërë nga AK Komuna e Junikut, ata prap këmbngulin që ne si OE nuk e plotësojmë gjendjen ekonomike dhe financiare të pikës III 2.3 kërkesën me numër 3 ku te kjo pikë kërkesa ka qenë:

*Kapital të njaftueshëm për realizimine kontratës, mjete të gatshme në bankë në vlerë prej së paku 300, 000.00 €. Dokumenti të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar që dëshmon se OE ka mjete financiare të gatshme sipas kërkesës.*

**SQARIM:** Tek rregullat dhe udhëzimet operative për Prokurimin Publik – kriteret e përzgjedhjes, kërkesat e përshtatshmërisë minimale të gjendjes ekonomike/financiare janë:

- a. Deklaratë aduckuate ose deklarata nga një ose më shumë banka; ose
- b. Dëshmi të plicës relevante të sigurimit të lëshuar nga një kompani e licencuar dhe me reputacion; ose
- c. Kopjet të certifikuar të një ose më shumë të pasqyrave të bilancit ose pjesë të pasqyrës së bilancit; ose
- d. Kopja e raporteve financiare dhe raportet e mengjimit të certifikuar nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavaruar; ose
- e. Deklarata tatimore vjetore të dorëzuar në Administratën Tatimore të Kosovës.

Një gjë e tillë kërkohet edhe tek raportet përkatëse nga një ose më shumë banka tek rregullat dhe udhëzimet operative për Prokurimin Publik.

**SQARIM:** Duke u bazuar në atë se çka ka deklaruar AK Komuna e Junikut mbi raportin vendimin e refuzimit nuk qëndron sepse ne si OE kemi përkrahjen nga Banka Raiffaisen një gjë e tillë e kemi dëshmuar përmes dokumentit të lëshuar nga banka e lartëcekur me numër të referencës: MD1923400003 se kemi mbështetjen e kësaj banke për implentimin e kësaj kontrate.

AK Komuna e Junikut, i referohet pikës III.2.4 kërkesa me numër 9 dhe 10 kinse dëshmia e ofruar nga ana jonë është në harmoni me kërkesën e AK sepse listat e pagave është vulosur vetëm nga institucion bankar dhe jo nga të gjitha bankat ku marrin paga punëtorët tanë.

Kërkesa nga AK në dosjen e tenderit ka qenë:

*9. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi nga Banka Listat e pagave që dëshmojnë se janë kryer obligimet ndaj stafit dhe punëtorëve. – 9. Nga Banka (Listat e pagave) të Operatorit Ekonomik që dëshmon se ka kryer obligimet ndaj punëtorëve (minimum 50 punëtorë) për 6 muajt e fundit e nënshkruar dhe vulosur nga banka.*

*SQARIM:* Ne i bëjmë me dije AK se ne kemi paraqitur listen nga banka të vulosur dhe nënshkruar nga banka me të cilën ne si OE bashkpunojmë. Është e vertëtë se punëtorët e kompanisë tonë kanë llogari bankare në bankat tjera mirëpo këto transaksione kryhen përmes Bankës Ekonomike dhe ne si dëshmi ju kemi sjellur listën. Gjithashtu, kemi paraqitur lista edhe nga ATK që janë paguar me rregull dhe kërkesat e vendosura nga AK Komuna e Junikut i kemi plotësuar në tërësi.

Sipas AK-së të kërkesat me numër 10 mbi makineritë e rënda kryesore për realizimin e projektit ne nuk e plotësojmë sepse na mungojnë makineri si psh. Buldozher D7.

I rikujtojmë Autoritetit Kontraktues se kërkesa nga ana juaj ka qenë: 1 Buldozher min. D7, ne si OE kemi ofruar 3 Buldozhera me kapacitet: D150, D5 dhe D10, dhe besojmë që është e plotësuar edhe kjo pikë.

Si kjo të gjitha makineritë e kërkuara nga AK i kemi ofruar sipas kërkesës në dosjen e tenderit, nëse AK ka pasur ndonjë paqartësi ka mundur të kërkojë informacione shtesë për sqarimin e këtyre pikave.

AK Komuna e Junikut ka angazhuar një komision për rivlerësimin e lëndës të cilët nuk kanë pregaditje/njohuri të cilat do t'i mundësonin vlerësimin e drejtë / sakt të këtij procesi. Gjithashtu, AK ka angazhuar anëtarë të komisionit të cilët kanë qenë në vlerësim edhe më herët dhe një gjë e tillë ligjërisht është e ndaluar.

Këto prova do i gjeni të bashkangjitura në ankesë.

Të gjitha këto konstatime dhe prova të lartëcekura vërtetojnë se AK në rastin konkret në mënyrë flagrante ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të lartëcekura të Lpp-së.

Nga të cekurat më lartë i propozojmë autoritetit kontraktues Organit Shqyrtues të Prokurimit OSHP-së, që kërkesën tonë për Rishqyrtim ta aprovojë si të bazuar dhe që i njëjti ta Rishqyrtojë gabimin e komisionit RI-VLERSUES dhe të kthejë lëndën në Rivlerësim e të na shpall neve si fitues meqenëse jemi Operator Ekonomik të vetmit të përgjegjshëm.

Në rast të ndonjë paqartësie ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni me qëllim të qartësimit të kërkesës sonë.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rasi se përfshini pretendime për kompensim.*

Janë të konsiderueshme sepse jemi të pregatitur për ekzekutimin e kësaj kontrate dhe jemi OE i përgjegjshëm, andaj dëmi material është i pa riparueshem po që se në vendim për Ri-shqyrtim OSHP-ja nuk e konsideron kërkesën tonë Konform Lpp-së.



## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*